



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 357, Datë 01.12.2023

**MBI
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË
KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “ENERGY FINANCING TEAM
TIRANA” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7, 9, pikat 4 dhe 5 dhe 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 01.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2195/6 prot., datë 22.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 127, datë 31.05.2022 dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 126, datë 31.05.2022. Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2195 prot., datë 26.09.2023 dhe nr. 2196 prot., datë 26.09.2023, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 100 % të kuotave të zotëruara nga ortaku “EFT INTERNATIONAL INVESTMENTS HOLDINGS LTD” sh.p.k., tek “EFT INVESTMENTS LIMITED”.
- Për të sqaruar dokumentacionin e konstatuar të munguar të këtij aplikimi, me shkresën nr. 2195/2 prot., datë 13.10.2023, ERE i njoftoi shoqërisë këtë dokumentacion dhe e ftoi në një seancë dëgjimore në datën 20.10.2023, e cila u zhvillua në datën 06.11.2023, pas kërkesës së paraqitur nga përfaqësuesit e shoqërisë, me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2195/3 prot., datë 18.10.2023 për shtyrjen e datës së zhvillimit të kësaj seance.

- Pas sqarimeve të dhëna në seancë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2195/4 prot., datë 06.11.2023, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë është depozituar dhe dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi.
- Duke qenë se marrëveshja për ndryshimin e ortakut kryesor të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. është nënshkruar përpara marrjes së autorizimit të ERE-s, nga ana e shoqërisë është depozituar dhe deklarata, ku ndër të tjera përcaktohet se, *marrëveshja nuk ka kurrësi për qëllim rënien ndesh me rregullat e lidhura me dy licencat e shoqërisë*, e po ashtu se, *shoqëria dhe Grupi EFT angazhohen të nënshkruajnë, depozitojnë, regjistrojnë dhe kryejnë çdo veprim të nevojshëm për rikthimin e strukturës së ortakërisë në gjendjen para nënshkrimit të Marrëveshjes në rast se kjo gjë do të jetë e nevojshme si dhe për të respektuar të gjitha kushtet e licencave të lëshuara nga ERE.*
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k.
2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “Energy Financin Team Tirana” sh.p.k., bëhet EFT INVESTMENTS LIMITED.
3. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta

çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI